

DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 07.01.2019

Për: **“SELAMI” sh.p.k** me perfaqesues ligjor z.Musa SELAMI, me adrese: *Peshkopi, Lgj. “Nazmi Rushiti”, Rr. “Tercilio Kardinali”,* me numer NIPTI **J 77304706 L**.

Procedura e prokurimit: *“E Hapur”*

Numri i referencës së procedurës/lotit : **REF-73533-06-05-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***“Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Peshkopi – Q.Draje, Peshkopi – Ushtelencë 52.7 km”.***

Me fond limit: **59 579 758 leke pa tvsh** (*pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë*) leke pa tvsh /Buxheti i Shtetit. Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 11.06.2018] [Numri 23]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Në këtë procedure prokurimi moren pjesë **6 (gjashtë) ofertues** ekonomik, përkatësisht:

1. **“A.L - ASFALT” sh.p.k**, me numer NIPTI **K 8151108 A**, perfaqesues ligjor Z.Astrit Varaku, me adrese: *Komuna Xhafzotaj prane kryqëzimit 4 rruget*, me oferte: **58 357 750 (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh dhe: 70 029 299 (shtatëdhjetë milion e njëzet e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) leke me tvsh.**
2. **“ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” sh.p.k**, me numer NIPTI **K 91326028 I**, perfaqesues ligjor Z.Arber Abazi, me adrese: *Rr. “ Reshit Petrela”, Kompleksi Ushuga kati i 8, Tirane*, me oferte: **54 993 367 (pesëdhjetë e kater milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh dhe: 65 992 041 (gjashtëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyzet e një) leke me tvsh.**
3. **B.O.E“ CURRI” shpk**, NIPT **J 67902718 S** përfaqësues ligjor Z. Faik Curri me adrese: *Rr. “Kajo Karafili”, Pallati Bimbashi 8/2, Shk.2, Kati II, Ap. 2 Tirane*, **kuotë përfaqësimi 50.50% & “ALB SHPRESA” sh.p.k**, me numer NIPTI **J 72110003 F**, perfaqesues ligjor Z.Mehdi Lala, me adrese: *Rr. “ Maliq Muço”, Nd. 6, Hyrja 4 , Ap. 14, Tirane* **kuotë përfaqësimi 49.50 %**, bashkimi i operatoreve përfaqësohet nga Z. Faik Curri administrator i “ CURRI” sh.p.k, me oferte: **40 973 075,65 (dyzet milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e pese presje gjashtëdhjetë e pesë) leke pa tvsh dhe: 49 167 960,78 (dyzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtëdhjetë presje shtatëdhjetë e tete) leke me tvsh.**
4. **B.O.E“SHEHU” sh.p.k**, me perfaqesues ligjor Z.Aqif Shehu, me adrese: *Ndertesa 1 – katëshe, Rruga Nacionale Peshkopi- Tirane, Maqellarë, Diber*, me NR NIPTI **J 66702707 S**, **kuotë përfaqësimi 60 %**, bashkuar me : **“ ALBADI” sh.p.k**, me përfaqësues ligjor Z. Xhelil Mazari, me adrese: *Peshkopi ,Lagjja "Aksioni", Rruga "Safet Zhulali", Nr NIPTI J 77304720 A*, **kuotë përfaqësimi 40 %**, përfaqësuar bashkimi nga Z. Aqif Shehu administrator i “ SHEHU” sh.p.k, me oferte: **53 882 751 (njëqind e trembëdhjetë milion e katerqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet) leke pa tvsh, 64 659 301 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e kater) leke me tvsh.**
5. **“SELAMI” sh.p.k** me perfaqesues ligjor z.Musa SELAMI, me adrese: *Peshkopi, Lgj. “Nazmi Rushiti”, Rr. “Tercilio Kardinali”,* me numer NIPTI **J 77304706 L**, me oferte: **49 038 270 (dyzet e nëntë milion e tridhjetë e tetë mije e dyqind e shtatëdhjetë) leke pa tvsh, 58 845 924 (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e dyzet e pesë mije e nëntëqind e njëzet e kater) leke me tvsh;**
6. Person fizik **Z.Adem Pojani**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Adem Pojani

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nuk plotëson asnjë nga kriteret e kualifikim pasi nuk është ngarkuar asnjë dokument ligjor në sistem.

2. “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCCION” sh.p.k,

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nuk plotësoni kushtet për kualifikim për sa ju perket mjeteve të punës që kerkohen për zbatimin e kontratës, pasi këto mjete janë të njëjta me ato të angazhuara në objektin: **“Kuben- Vasije 35.4 km”**, në të cilin jeni kualifikuar dhe renditur i pari, prandaj mjetet tuaja rezultojnë të angazhuara në tjetër objekt, në kundërshtim me atë që është përcaktuar në kriteret për kualifikim.

3. B.O “ CURRI” shpk, & “ALB SHPRESA” sh.p.k

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike me nr.4761 prot, dt.05.06.2018 leshuar në emër të kërkuarit “ Alb Shpresa” sh.p.k, shpreh se kontrata me kod TR1C11008111106 është në emër të “ Curri” sh.p.k, në kundërshtim me pikën 2 Kriteret e vecanta të Kualifikimit, pika 1 germa “d” që përcakton detyrimin për paraqitjen e një ” Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.
Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

2. Bashkimi i operatoreve “CURRI” sh.p.k& “ ALB SHPRESA” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetin e punës “ autobetoniere”. Më saktë, nga ri-verifikimi rezulton se mjeti i punës me Nr. C15137 “ Autobetoniere”, marrë me qera nga “ Mela” sh.p.k për llogari të “Alb shpresa” sh.p.k, është i njëjti mjet i paraqitur nga B.O.E “ EKSLUZIV” sh.p.k, & “MELA.” shpk, të shpallur fitues në objektin: Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “U.Matit - Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U.Fanit)- Shpal, Shpal- Q.Benë- K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit 84.9 km”, me të cilët është finalizuar edhe kontrata.

Fakt ky, që vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46/ b) i LPP-së ku thuhet se për të provuar aftësinë teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se: zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Pas verifikimit të dokumentacionit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, rezulton se bashkimi i operatoreve në fjalë nuk ka paraqitur mjetin e kërkuar, në kundërshtim me ato çfarë përcakton neni i sipërcituar.

Pas këtyre konstatimeve rezulton se ndodhemi përballë situatës ku operatori CURRI” sh.p.k& “ ALB SHPRESA” sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.7, i cili përcakton: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe makineritë që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik”. E shoqëruar pastaj, me leje qarkullimi, certifikate të kontrollit teknik, foto etj si dhe me pikën 2.3.8 ku thuhet :”Makineritë e mesipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në

kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera per te gjithë periudhen e percaktuar si afati i kryerjes se shërbimit".

4. B.O“SHEHU” sh.p.k, &“ ALBADI” sh.p.k

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Shoqeria " ALBADI" sh.p.k nuk ka paraqitur vertetim qe konfirmon shlyerjen e detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave qe ka operatori ne fjale, ne kundërshtim me piken 2/d te "kriterëve te vecanta te kualifikimit";
 2. Shoqeria " SHEHU" sh.p.k, ka paraqitur kontrate qeraje per mjete pune borepastruese, por qe figurojne pa targa dhe specifikimet e duhura, ne kundërshtim me piken 2.3.7 te " kriterëve te vecanta te kualifikimit" , shkronja "d" dhe "h".
- Ne keto kushte, Autoriteti Kontraktor e ka te pamundur verifikimin e mjeteve te punes nese jane te njejtë me ato per te cilet eshte lidhur kontrata.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“SELAMI” sh.p.k** me perfaqesues ligjor z.Musa SELAMI, me adrese: *Peshkopi, Lgj. “Nazmi Rushiti”, Rr. “Tercilio Kardinali”*, me numer NIPTI **J 77304706 L**, me oferte: **49 038 270** (dyzet e nëntë milion e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) **leke pa tvsh, 58 845 924** (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e kater) **leke me tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise Rajonit Verior Shkoder, me adrese: Rr. *“At Zef Valentini”* , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin **“A.L - ASFALT” sh.p.k**, me numer NIPTI **K 8151108 A**, perfaqesues ligjor Z.Astrit Varaku, me adrese: *Komuna Xhafzotaj prane kryqëzimit 4 rruget* , me oferte: **58 357 750** (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) **leke pa tvsh dhe: 70 029 299** (shtatëdhjetë milion e njëzet e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) **leke me tvsh**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Riklasifikimit është bërë në datë **26.11.2018**

Ankesa: **Po.**

Faza e vlerësimit dhe e klasifikimit të ofertave, përfundoi me datë 25/07/2018 pasi iu dha edhe konfirmimi në sistem nga personi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas mbylljes së fazes së vlerësimit, la në dispozicion të ofertuesve afatin 7 (shtatë) ditor per paraqitjen e ankesave në lidhje me vlerësimin.

Brenda afati ligjor 7 ditor u paraqiten ankesat si me poshte vijon:

Ne daten 31.07.2018 ka paraqitur prane AK formularin e ankeses nr 63 prot, sipas shtojces se percaktuar ne DST, subjekti Bashkimi i Operatoreve ekonomik

2. “CURRI”sh.p.k & “ALB SHPRESA” sh.p.k, regjistruar nga AK me nr prot 311 dt.31.07.2018.

Ne lidhje me ankesat e ketij subjekti Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder, ka dale me vendimin e dates 06.08.2018, i cili i eshte percjelle subjektit ankimues me shkresen **nr.325 prot, date 06.08.2018**, sipas ketij vendimi **ankesa e ketij subjekti nuk eshte pranuar** nga ana e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave duke i qendruar vleresimit qe ka bere KVO pranë Autoritetit Kontraktor,(bashkengjitur ju dergojme kopje te formularit te ankeses dhe te pergjigjes se ankeses).

Ne lidhje me kete objekt prokurimi eshte ankuar gjithashtu edhe shoqeria

3. “Alko Impex General Constuction” sh.p.k, i cili ka paraqitur ankesen prane Autoritetit Kontraktor me date 31.07.2018, regjistruar me nr.313 prot.

Ne lidhje me ankesat e ketij subjekti Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder, ka dale me vendimin e dates 06.08.2018, i cili i eshte percjelle subjektit ankimues me shkresen nr.326 prot, date 06.08.2018, sipas ketij vendimi ankesa e ketij subjekti nuk është pranuar nga ana e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave duke i qendruar vleresimit qe ka bere KVO pranë Autoritetit Kontraktor.

Brenda afatit ligjor ky subjekt nuk ka paraqitur ankesa prane Institucionit tuaj ne lidhje me vendimin e Autoritetit Kontraktor.

Me date 17.08.2018 jemi vene ne dijeni qe subjekti ankimues “CURRI” sh.p.k +” ALB SHPRESA” sh.p.k, i është drejtuar KPP-së, me ankesen nr 72/1 prot, nën cilësinë e organit epror per shqyrtimin e ankeses ne themel.

Me depozitimin e ankesës së subjektit “CURRI” sh.p.k pranë KPP-së, ky i fundit doli me vendimin Nr.1403/1,datë 20.08.2018, protokolluar nga AK me Nr 353, dt.24.08.2018 per pezullimin e procedures.

KPP me vendimin Nr.718/2018, percjellë me shkresen nr 718/1 date 23.10.2018 , protokolluar me tonen nr 434, dt. 25.10.2018, nder të tjera vendosi: Shfuqizimin e vendimit te KVO-se lidhur me s’kualifikimin e operatorit ekonomik B.O.E “CURRI” sh.p.k& “ ALB SHPRESA” sh.p.k, pranimin e ankeses se subjektit “CURRI” sh.p.k& “ ALB SHPRESA” sh.p.k, anulimi i vendimit te KVO-se, rivleresimi per kete objekt ne favor te subjektit ankimues, informimin e KPP-se per zbatimin e ketij vendimi.

Ri-vlersim i kryer në sistem me 31.10.2018.

AK me shkresen nr 445 prot, dt.01.11.2018 informon KPP-ne per zbatimin e vendimit, duke lënë në dispozicion të ofertuesve të drejten e ankimimit, brenda afateve ligjore, pas këtij ri-vlerësimi, si rezultat i të cilit u rëndit i pari operatori “CURRI”sh.p.k & “ALB SHPRESA” sh.p.k.

Si rezultat, brenda afatit ligjor 7 –ditor paraqiten ankesa:

1. “ SELAMI “ sh.p.k me ankesen e dates 05.11.2018, protokolluar nga AK me Nr.457, dt.05.11.2018.
2. “ SHEHU” sh.p.k, me ankesen e dates 01.11.2018, protokolluar nga AK me nr 458, dt.06.11.2018, të cilit i është kthyer pergjigje me shkresen nr. 478/1, dt.12.11.2018 duke mos shqyrtuar pretendimet e ngritura nga subjekti në fjalë, referuar edhe faktit që ky subjekt nuk kishtë ngritur ankesë gjatë fazes se parë te vlerësimit.

Me shkresen nr 476, dt.12.11.2018 AK i bëri kërkesë për interpretim KPP-së, per efekt te interpretimit dhe vlerësimit te fakteve të reja dhe me qëllim mos zvarritjen në kohë të kësaj procedure.

KPP me shkresen nr 718/6, dt.21.11.2018, protokolluar nga AK me nr 496, dt.22.12.2018 i komunikon AK-së pergjigjen në lidhje me interpretimin e kërkuar duke theksuar faktin se AK gjendet në kushtet e aplikimit të nenit 63, të LPP-së, shqyrtimi i ankesave.

Nga sa më sipër,

AK me vendimin e dates 23.11.2018, vendos pranimin e ankeses së subjektit “ Selami” sh.p.k, percjelle me shkresen nr 504 prot, duke i celur rruge afateve të ankimimit rishtazi, si pasojë e **ri-vlerësimit të bërë në sistem dt. 26.11.2018** (i treti per nga radha) bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, per pranimin e ankeses së subjektit “

SELAMI”sh.p.k, i cili u rendit i pari referuar cmimit me te ulet.

Si rrjedhoje, brenda afatit 7 ditor per paraqitjen e ankesave, pranë AK-së ngriti ankesë

1. B.O.E “ CURRI” sh.p.k + “ ALB SHPRESA” sh.p.k, me nr 107 prot, dt.28.11.2018, protokolluar nga AK me nr 518, dt.03.12.2018, ku përveç argumentimeve që operatori në ushtrim të së drejtes së tij, ngre dhe arsyeton, shan dhe ofendon antaret e Komisioneve të AK-së, pa asnjë të drejtë ligjore dhe morale.

AK i kthen pergjigje me shkresen Nr.527, dt.05.12.2018, duke rrëzuar ankesen e subjektit në fjalë me fakte konkrete.

Gjithashtu paraqiti ankese subjekti

2. “ SHEHU “ sh.p.k, me nr 150, dt.03.12.2018, protokolluar nga AK me nr 519, dt.03.12.2018, i cili mori pergjigje nga AK me shkresen Nr.529, dt.05.12.2018, ku u vendos rrëzimi i ankeses duke e shoqëruar me fakte konkrete.

Subjekti “ CURRI” sh.p.k + “ ALB SHPRESA” sh.p.k, i drejtohet KPP-së me ankesë nr 113/2, dt.12.12.2018, protokolluar nga AK me nr 542, dt.13.12.2018.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.2/2019, date 04.01.2019, protokolluar nga AK me Nr 06, dt.07.01.2019 nder te tjera vendosi:

1. Te mos pranoje ankesene paraqitur nga operatori ekonomik B.O.E “Curri” Sh.p.k & “ Alb Shpresa” sh.p.k, per kete procedure prokurimi.
2. Autoriteti kontraktor lejohet te vijoj me hapat e metejshem te procedures se prokurimit.